

VENDIM
Nr. 190, datë 15.3.2017

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KOLONJË, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MOLLAS, TË PRONËS ME NUMËR PASURIE 321, NË ZONËN KADASTRALE 2691, ME SIPËRFAQE 19350 m², DHE PËR NJË NDRYSHIMNË VENDIMIN NR. 1087, DATË 23.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN MOLLAS, TË QARKUT TË KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “e”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, në njësinë administrative Mollas, të pronës me numër pasurie 321, e ndodhur në zonën kadastrale 2691, me sipërfaqe 19 350 (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë) m², sipas planrilevimit dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e stacionit të transferimit të mbetjeve të ngurta dhe të varrezave publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1087, datë 23.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të shtohet prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Bashkisë Kolonjë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Në vendimin nr. 1087, datë 23.7.2008, të Këshillit të Ministrave, në titull dhe kudo në përmbajtjen e tij, fjalët “...në komunën Mollas...” zëvendësohen me “...në njësinë administrative Mollas, Bashkia Kolonjë...”.

5. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE **(Per inventarizimin e pronave te vecanta)**

Bashkia : KOLONJE

Supervizoi : Ganiart Emimi Pergj. Kadastres

Fusha e perdorimit te prones : Infrastrukture dhe sherbime publike.

Nr.	A			B			C			
	Zona Kadastr.Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji Pasurise	EmriPrones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni /Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni /Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2691 K-34-126-(199-B)	321	Sheshe +Truall	Fshati Millec	5000.0		Stacion Transferimi te mbeetjeve te ngurta te Bashkise Kolonje	Bashkia Kolonje	Bashkia Kolonje	Ne kete prone do te ndertohet objekti "Stacioni i Tansferimit te mbeetjeve te ngurta te rrethit Kolonje.
2	2691 K-34-126-(199-B)	321	Sheshe + Truall	Fshati Millec	14 350.0		Infrastrukture dhe sherbime publike	Bashkia Kolonje	Bashkia Kolonje	

